



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi

Mbledhja nr. 39
Prishtinë, më 15.10.2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ismajl Kurteshi, kryetar, Teuta Haxhiu, Valentina Bunjaku – Rexhepi, Albulena Balaj – Halimaj, Mufera Shinik, Fidan Rekalju dhe Arbërie Nagavci.

Munguan: Driton Çausi, Verica Çeraniq dhe Abdyl Salihu.

Përfaqësues të tjerë: Mevlide Shamolli – Ministria e Financave, Rrahman Jashari e Ymer Ymeri - SBASHK, KDI dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Rudinë Fetahaj.

Mbledhjen e kryesoi, Ismajl Kurteshi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky :

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr.06/L-073 për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99;

Ismajl Kurteshi, tha se Komisioni ka mbajtur disa takime lidhur me këtë projektligj dhe në vazhdim propozoi diskutimin e propozim amendamenteve.

Rrahman Jashari, tha se SBASHK-u nuk e pranon këtë version të amendamentimit të projektligjit dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit që të votohet drafti që ka ardhur nga Qeveria. Sipas tij, është e papranueshme që mësimdhënësit të cilët kanë rrezikuar jetën për 5 ose 9 vite t'iu shtohen 10 apo 20 euro më shumë, duke e cilësuar edhe si ofendim ndaj kësaj kategorie. Për më tepër, ai tha se pensioni që është kërkuar, ka qenë meritore dhe nuk është dashur që Komisioni të ndërhyjë.

Ismajl Kurteshi, tha se në hartimin e amendamenteve kanë marrë pjesë vazhdimisht përfaqësues të Qeverisë, organizma të ndryshëm ndërkombëtarë që veprojnë në Kosovë dhe që kërkesat e tyre kanë qenë të llojllojshme e që ka pasur kërkesa edhe për heqjen komplet të këtij projektligji. Ai tha se anëtarët e komisionit kanë marrë pjesë në shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji dhe se këto propozim amendamente janë bërë me konsensus.

Teuta Haxhiu, në diskutimin e saj kërkoi nga përfaqësuesit e SBASHK-ut që të analizojnë propozim amendamentet e Komisionit, me të cilat nuk pajtohen dhe të vijnë me propozime në Komision sepse ky projektligj nuk rregullon pensionet të cilat i kanë marrë deri tani. Gjithashtu, ajo theksoi që për këtë ligj ka pasur shumë politikë prej faktorëve të ndryshëm politik. Ajo tha se me 40 vite përvojë pune dhe 75 euro pension, është më shumë se shkelje e të drejtave ndërkombëtare të njeriut. Nuk janë ofruar shifrat e sakta për përfituesit e kësaj kategorie, me qëllim që ky ligj të mos kalojë fare, mirëpo, ajo theksoi që është shumë e bindur që ekziston vullneti i të gjithëve që ky ligj të kalojë.

Mevlide Shamolli, tha se, edhe pse MASHT-i është bartës, sa i përket këtij projektligji dhe kalkulimeve për numrin e përfituesve, Ministria e Financave ka qenë e gatshme të ndihmojë në aspektin profesional, mirëpo, që nuk është organ vendimmarrës. Për më tepër, ajo tha se Ministria e Financave ka angazhuar forca shtesë për të bërë kalkulimet e duhura në mënyrë që

ky ligj të jetë i zbatueshëm në praktikë, mirëpo që kjo ministri nuk duhet të shikohet asnjëherë si pengesë për zbatimin e këtij ligji.

Rrahman Jashari, tha se qëllimi i SBASHK-ut është që të mos i lejojë deputetët të gabojnë sepse ky projektligj nuk e rregullon statusin e mësimitdhënësve të viteve të 90-ta, ashtu edhe siç është planifikuar qysh në fillim. Ai tha se nuk janë kërkuar shtesa, mirëpo pensione për këtë kategori të mësimitdhënësve sepse shteti është i obliguar ta njohë këtë kontribut, jashtë pensioneve bazë që do të marrin.

Fidan Rekalu, tha se projektligji i mësimitdhënësve të viteve të 90-ta duhet të jetë i veçantë dhe të merren parasysh kërkesat e SBASHK-ut. Pajtohet plotësisht me përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe që mësimitdhënësit e viteve të 90-ta janë shtylla kryesore e këtij vendi, e që falë këtyre mësimitdhënësve, shumë gjenerata sot nuk janë analfabetë dhe si të tillë do ta kenë një ligj meritator.

Ismajl Kurteshi, falënderoi deputetin Rekalu dhe theksoi se Komisioni është i gatshëm ta shqyrtojë edhe njëherë ligjin nen për nen, nëse ai garanton që do të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit. Ai tha se do të ishte mirë sikurse të gjithë ata që kanë munguar në mbledhje, ta shqyrtojnë ligjin dhe të vijnë me propozime konkrete.

Albulena Balaj -Halimaj, tha se nëse edhe vetëm njëherë kolegu vjen në mbledhje, e ka të drejtën e shprehjes së mendimit.

Ismajl Kurteshi, tha se mungesat duhet përmendur për shkak se është tallje dhe papërgjegjësi ndaj anëtarëve e Komisionit që kanë ardhur çdo mbledhje dhe kanë kontribuar në projektligj.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se me këto shtesa aktuale ky ligj do të jetësohej edhe para 10 viteve, por kategoria e mësimitdhënësve të viteve të 90-ta është kategori e veçantë. Ajo tha se që nga fillimi, Ministria e Punës, e Arsimit dhe e Financave, nuk kanë qenë të dakorduara në mes vete duke shkaktuar kështu polemika. Gjithashtu, ajo theksoi që nëse nuk ka buxhet të mjaftueshëm, atëherë të kalojnë edhe 5 vite tjera, mirëpo ligji që do të vijë, ta gëzojnë këta mësimitdhënës ose edhe fëmijët e tyre. Ajo tha se është shumë e lehtë me e sjellë ligjin dhe mos të miratohet, mirëpo, këto shtesa aktuale janë fyerje për kategorinë e mësimitdhënësve të viteve të 90-ta.

Ismajl Kurteshi, tha se me procesverbale është e dëshmuar që të gjitha këto nene që janë aprovuar nga Komisioni, janë aprovuar me konsensus dhe asnjëri nga anëtarët e Komisionit nuk ka qenë kundër.

Valentina Bunjaku – Rexhepi, tha se vetëm një mungesë nuk e mohon të drejtën e deputetit që të ofrojë mendimin e tij lidhur me këtë projektligj. Ajo tha se të gjithë anëtarët e Komisionit janë të barabartë, që mbledhjet i vijnë sipas mundësisë dhe që secili i merr mëditjet për vete. Ajo tha se nuk është kundër krejt projektligjit, mirëpo vetëm sa i përket shtesave që kanë dhe që sipas saj, duhet të jenë minimumi 300 euro për person, dhe në rast se nuk ka të holla të mjaftueshme, Ministria e Financave duhet ti gjejë paratë aty ku ua merr mendja, sepse ky nuk është problem i Komisionit.

Ismajl Kurteshi, shprehi keqardhje që njerëzit flasin ndryshe para kamerave dhe ndryshe në grupe punuese. Ai tha se shpeshherë mbledhjet janë ndërprerë për shkak të mungesës së kuorumit dhe që ky është një realitet që duhet pranuar. Gjithashtu, ai tha se Komisioni do ta shqyrtojë nen për nen edhe njëherë, do të votohet dhe do të dërgohet në Kuvend.

Albulena Balaj-Halimaj, tha se kjo mbledhje është dashur të anulohet për shkak të seancës sepse deputetët nuk kanë mundësi ta shfrytëzojnë as kohën e pauzës. Ajo tha se ka dyshime që Komisioni ka qenë shumë i ndikuar nga opinionet e të tjerëve, duke përmendur këtu Ministrinë e Financave, ndërkombëtarëve etj. Sipas saj, këto opinione kanë ndikuar që të mos arrihet asgjë, sepse nëse një mësues fiton 10 euro ose 20 më shumë, është fyerje dhe nuk është bërë asgjë. Ajo tha se nuk është kundër kategorizimit të përfituesve, përkatësisht tek neni 7, mirëpo, duhet gjetur një formë tjetër. Ajo propozoi që kjo mbledhje të anulohet dhe që Komisioni të takohet në një ditë tjetër dhe të vendoset përfundimisht.

Arbërie Nagavci, tha se është shumë shqetësuese që edhe në këtë moment është duke u bërë shumë politikë për interesa të ngushta partiake dhe kundër interesave edhe të vet mësuesve të viteve të 90-ta, e edhe të interesave të përgjithshme të vendit. Si deputete dhe si anëtare e Komisionit, është përgjegjësi me e pa interesin e përgjithshëm dhe të sigurohemi që ligji të jetë i zbatueshëm. Gjithashtu, ajo tha se është e vërtetë që janë mbajtur shumë grupe punuese lidhur me këtë ligj dhe që janë marrë shumë mendime nga departamente, ministri dhe organizata të ndryshme, mirëpo, kjo është bërë për të mirën e këtij projektligji, sepse duhet të merren parasysh mendimet e ndryshme profesionale, duke qenë që nuk jemi të gjithë ekspertë të

financave. Nagavci tha se vota për këtë ligj duhet të jetë profesionale e jo për arsye elektorale ose shtyrje përpara e agjendave të ngushta.

Ismajl Kurteshi, tha se deputetët të cilët nuk kanë pasur mundësi për të qenë pjesë aktive e punës së Komisioni të sjellin propozime konkrete për projektligjin dhe se është e papërgjegjshme të fillohet nga e para për shkak të mungesës së disa deputetëve.

Teuta Haxhiu, tha se e përkrah draftin e projektligjit të propozuar nga Qeveria, pa e ndryshuar. Ajo tha se kategorizimi është bërë me qëllim të mos barazohen personat që kanë punuar një vit me ata të cilët kanë punuar dhjetë vite. Gjithashtu, ajo theksoi që neni 7, do të diskutohet dhe Komisioni mirëpret rekomandimet e SBASHK-ut, mirëpo, tha që do të ishte mirë sikur të ekzistonin shifrat e sakta për përfituesit e këtij projektligji.

Ismajl Kurteshi, tha se për shkak të mospajtimeve dhe kërkesave për shtyrje të mbledhjes, propozoj që anëtarët e Komisionit që kanë qëndrim tjetër nga ajo që është propozuar, të punojnë së bashku me SBASHK-un dhe të i sjellin me shkrim vërejtjet në lidhje me këtë projektligj.

4.Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,
Ismajl Kurteshi